

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.0201-1054/4 datë 01.03.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, miratoi si në vijim:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2), për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 2 shkurt 2024, nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET që NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2), në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij, llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente të kryej mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të pakove programorekako që i ritransmetojnë operatorët e rrjetëve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, certifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë vërejtje publike në rastet kur konstatohet mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi (1) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruar gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi publik radiodifuziv së paku 40%.

Në kuadër të kompetencave të saj Ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 20 shkurt 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2), transmetuar më 2 shkurt 2024, në nivel shtetëror, nga ku konstatoi se shërbimi i dytë programor televiziv i NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2), ka transmetuar 7 orë 52 minuta dhe 27 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që është 35.64% nga totali i programit të transmetuar gjatë ditës e cila hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (22 orë 5 minuta dhe 39 sekonda). Minimumi Ligjor prej 40% për transmetim të

programit të krijuar burimor gjatë një dite, në lidhje me totalin e programit të transmetuar më 2 shkurt, që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (22:05:39), është 8 orë 50 minuta dhe 15 sekonda. Shërbimi i dytë programor televiziv i Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM2), ka transmetuar për 57 minuta dhe 48 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2) më 21.02.2024, dërgoi Shkresë ark.nr.1001-934/2 datë 21.02.2024, me të cilën i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të Shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzohet deklarata me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 22.02.2024, për të cilën NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2), dorëzoi deklarata me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV, ark.nr.14-1253/2 datë 23.02.2024 (nr ynë.ark.1001-934/3 datë 23.02.2024). Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 01.03.2024, pasi shqyrtoi lëndë Raport me shkrim dhe deklarata të dorëzuara me shkrim, konkludoi që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2) t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.0201-1054/4 datë 01.03.2024, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbim i dytë programor (TVM 2) dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart, është marrë aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.1001-934/1 datë 20.02.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.